



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 5

Tiranë – E hënë, 11 shkurt 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Njoftim i Komisionit Institucional të Zgjedhjeve pranë Universitetit të Arteve nr. 11, datë 29.1.2019	Për publikimin e formularit tip mbi zgjedhjet e anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë..... 3
Njoftim i Komisionit Institucional të Zgjedhjeve pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës, nr. 122, datë 1.2.2019	Për shpalljen e fillimit të procedurave për zgjedhjen e anëtarit të Bordit të Administrimit të UBT, të propozuar nga studentët..... 4
Njoftim i Komisionit Institucional të Zgjedhjeve pranë Universitetit të Arteve nr. 31, datë 5.2.2019	Për shtyrjen e procesit të regjistrimit për anëtarët e Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë..... 4
Njoftim i Universitetit të Sporteve të Tiranës, nr. 265, datë 6.2.2019	Për aplikimin e kandidatëve për anëtar të Bordit të Administrimit në Universitetit të Sporteve të Tiranës..... 7
Kërkesë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nr. 622/1, datë 6.2.2019	Për shprehje interesi për shërbim konsulence, “Ekspert prokurimi”, Konsulent Individual Lokal - Ref. no. SAMP/CS/IC/02-2019..... 8
Njoftim i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nr. 1154, datë 11.2.2019	Për shpalljen e pozicionit Këshilltar Ligjor në institucionin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit..... 9



NJOFTIM
Nr. 11, datë 29.1.2019

PËR PUBLIKIMIN E FORMULARIT TIP MBI ZGJEDHJET E ANËTARËVE TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT, PËRFAQËSUES TË MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR ARSIMIN, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË

		REPUBLIKA E SHQIPERISE UNIVERSITETI I ARTEVE KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE	
KËRKESË PËR REGJISTRIM SI KANDIDAT PËR ANËTAR TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT			
Bazuar në VKM nr. 782, datë 26.12.2018, Shkresës së MASR me Nr. 322, Prot., datë 14.01.2019, si dhe VSA nr. 06 më datë 23. 01. 2019 për "Shpaltjen e zgjedhjeve të reja, për 1 vend nga radhët e përfaqësuesve të MASR, si ekspertë të njohur në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike, për anëtar të bordit të administrimit, i cili do të përzgjidhet nga studentët e Universitetit të Arteve".		Numri i regjistrimit plotësohet nga KIZ Nr. _____ regj. Datë _____	
FUNKSIONET E BORDIT TË ADMINISTRIMIT			
1. Garanton qëndrueshmërinë financiare të institucionit të arsimit të lartë dhe përmbushjen e misionit të tij. 2. Me propozim të Senatit Akademik, miraton planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tij. 3. Me propozim të Senatit Akademik, miraton buxhetin vjetor dhe atë afatnesëm të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre. 4. Me propozim të Senatit Akademik, miraton numrin e personelit në të gjitha nivelet. 5. Vlerëson paraprakisht mbylljen dhe riorganizimin e institucionit të arsimit të lartë, si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë me një institucion tjetër të arsimit të lartë. 6. Miraton paraprakisht hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësisë përbërëse të institucionit të arsimit të lartë. 7. Jep mendim për projekt rregulloren e institucionit dhe miraton rregulloren financiare të tij. 8. Përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit. 9. Është përgjegjës për caktimin e kriterëve e të procedurave për punësimin e administratorëve dhe personelit administrativ, mbështetur në aktet institucionit të lartë. 10. Emëron dhe shkarkon administratorin e institucionit. 11. Miraton paraprakisht statutin e institucionit të arsimit të lartë përpara se t'i përcillet Senatit Akademik. 12. Miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit, të hartuar nga Rectorati.			
KRITERET PËR TË KANDIDUAR PËR ANËTAR TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT			
1. Të jenë ekspertë të njohur nga fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike. 2. Të jetë person me profil publik dhe arritje të shquara brenda apo jashtë vendit, në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike. 3. Të ketë integritet etik dhe profesional. 4. Të mos jetë i angazhuar në funksione drejtuese partiake. 5. Të mos jetë i dënuar penalisht, me vendim gjyqësor të formës së prerë (është i vlefshëm edhe vetëdeklarimi dori në marrjen e dokumentit) 6. Të mos ketë konflikt interesin në përmbushje të kërkesave dhe dispozitave ligjore për parandalimin e konfliktit të interesave.			
DOKUMENTACIONI SHOQËRUES			
1. Fotokopje e dokumentit të identifikimit 2. Fotokopje e titullit akademik (nëse ka) 3. Dokumentacion shtesë që kandidati e vlerëson të rëndësishëm në mbështetje të kandidimit të tij			
TË DHËNA TË KANDIDATIT (Plotëso me gërma të mëdha, vendos shenjë X ne kuti)			
Emri			Data e kërkesës
Atësta			Nr. LTD
Mbiemri			Gjinia M ☐ F ☐
Datëlindja	Dita / /	Muaji / /	Viti / /
Pozicioni aktual (para kandidimit)			
Unë aplikantë paraqes KËRKESË për regjistrim si kandidat për anëtar të Bordit të Administrimit, pasi jam njohur dhe në përputhje me VKM nr. 782, datë 26.12.2018, shkresën së MASR me Nr. 322, Prot., datë 14.01.2019, si dhe VSA nr. 06 më datë 23. 01. 2019 për "Shpaltjen e zgjedhjeve të reja, për 1 vend nga radhët e përfaqësuesve të MASR, si ekspertë të njohur në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike, për anëtar të bordit të administrimit, i cili do të përzgjidhet nga studentët e Universitetit të Arteve", për zgjedhjet që do të mbahen në datën 20 Shkurt 2019. Gjithashu deklaroj se të dhënat e paraqitura nga ana ime në këtë kërkesë si dhe dokumentacioni shoqërues janë të sakta dhe të vërteta. Jam në dijeni se deklaratimet e mëtejshme nga ana ime në këtë kërkesë si dhe paraqitja e dokumenteve të falsifikuara, përveç përgjegjësisë penale, sjell automatikisht heqjen e të drejtës për kandidim.			
KANDIDATI _____ Emri dhe mbiemri		NËNSHKRIMI _____	

**NJOFTIM****Nr. 122, datë 1.2.2019****PËR SHPALLJEN E FILLIMIT TË
PROCEDURAVE PËR ZGJEDHJEN E
ANËTARIT TË BORDIT TË
ADMINISTRIMIT TË UBT, TË
PROPOZUAR NGA STUDENTËT**

1. Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.7.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 49, “Funksionet e Bordit të Administrimit në institucionet e arsimit të lartë”, pika 1, përcakton si më poshtë:

a) garanton qëndrueshmërinë financiare të institucionit të arsimit të lartë dhe përmbushjen e misionit të tij;

b) me propozim të Senatit Akademik, miraton planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tij;

c) me propozim të Senatit Akademik, miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre;

ç) me propozim të Senatit Akademik, miraton numrin e personelit në të gjitha nivelet;

d) vlerëson paraprakisht mbylljen dhe riorganizimin e institucionit të arsimit të lartë, si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë me një institucion tjetër të arsimit të lartë;

dh) miraton paraprakisht hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive përbërëse të institucionit të arsimit të lartë;

e) jep mendim për projekt-rregulloren e institucionit dhe miraton rregulloren financiare të tij;

ë) përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit;

f) është përgjegjës për caktimin e kriterëve e të procedurave për punësimin e administratorëve dhe personelit administrativ, mbështetur në aktet e institucionit të arsimit të lartë;

g) emëron dhe shkarkon administratorin e institucionit;

gj) miraton paraprakisht statutin e institucionit të arsimit të lartë, para se t'i përcillet Senatit Akademik;

h) miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë.

2. Kriteret që duhet të plotësohen nga kandidatët përfaqësues të studentëve për vendin e anëtarit në Bordin e Administrimit të Universitetit Bujqësor të Tiranës, në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 782, datë 26.12.2018, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse, në institucionet e arsimit të lartë”, pika 11, janë:

- Të ketë integritet etik dhe profesional.

- Të mos jetë i angazhuar në funksione drejtuese partiake.

- Të mos jetë dënuar penalisht me vendim gjyqësor të formës së prerë.

- Të mos ketë konflikt interesi në përmbushjen të kërkesave dhe dispozitave ligjore për parandalimin e konfliktit të interesave.

3. Dokumentacioni që duhet të paraqitet pranë KIZ-it:

- Formulari i aplikimit, i cili tërhiqet pranë KIZ-it të UBT-së (Universiteti Bujqësor i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit, Godina B, Zyra 105).

- Kopje e një dokumenti identifikimi (pasaportë/kartë identiteti)

4. Afati dorëzimit të aplikimit fillon nga data 1.2.2019, deri më datë 12.2.2019.

NJOFTIM**Nr. 31, datë 5.2.2019****PËR SHTYRJEN E PROCESIT TË
REGJISTRIMIT PËR ANËTARËT E
BORDIT TË ADMINISTRIMIT,
PËRFAQËSUES TË MINISTRISË
PËRGJEGJËSE PËR ARSIMIN, NË
INSTITUCIONET PUBLIKE TË
ARSIMIT TË LARTË****VENDIM****Nr. 16, datë 4.2.2019**

Bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 782, datë 26.12.2018, pika 6, për “Përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë”, shkresën e MASR-it me nr. 322, prot., datë 14.1.2019, pika 5, vendimin e Senatit Akademik nr. 6, më datë



23.1.2019 për “Shpalljen e zgjedhjeve të reja, për 1 vend nga radhët e përfaqësuesve të MASR-it, si ekspertë të njohur në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike, për anëtar të Bordit të Administrimit, i cili do të përzgjidhet nga studentët e Universitetit të Arteve”, vendimit nr. 10, datë 26.1.2019 të KIZ UART-it dhe rregulloren “Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

KIZ UART-i, pas përfundimit të afatit të regjistrimit të kandidatëve për anëtar të Bordit të Administrimit dhe regjistrimit në proces të një kandidati të vetëm; pasi shqyrtoi bazën ligjore të mësipërme, specifikisht pikën 6 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 782, datë 26.12.2018, dhe pikën 5 të shkresës së MASR-it me numër 322 prot., datë 14.1.2019, vlerësoi se në mungesë

të kandidaturave të mjaftueshme nuk mund të shpallë listën e kandidatëve të regjistruar për anëtar të Bordit të Administrimit në UART dhe, për sa më sipër, vendosi:

Të shtyjë procesin e regjistrimit të kandidatëve për anëtar të Bordit të Administrimit në UART. Periudha e dytë e regjistrimit të kandidatëve për anëtar të Bordit të Administrimit fillon në datën 11.2.2019, ora 08:00, deri në datën 13.2.2019, ora 16:00.

Të gjithë të interesuarit për të vetëkandiduar për pozicionin e anëtarit të Bordit të Administrimit ftohen të depozitojnë formularin e aplikimit së bashku me dokumentacionin shoqërues pranë KIZ-it.

**KRYETAR
Alert Çeloaliaj**



 REPUBLIKA E SHQIPERISE UNIVERSITETI I ARTEVE KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE	
KËRKESË PËR REGJISTRIM SI KANDIDAT PËR ANËTAR TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT	
Bazuar në VKM nr. 782, datë 26.12.2018, Shkresës së MASR me Nr. 322, Prot., datë 14.01.2019, si dhe VSA nr. 06 më datë 23. 01. 2019 për “Shpalljen e zgjedhjeve të reja, për l vend nga radhët e përfaqësuesve të MASR, si ekspertë të njohur në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike, për anëtar të bordit të administrimit, i cili do të përzgjidhet nga studentët e Universitetit të Arteve”.	Numri i regjistrimit plotësohet nga KIZ Nr. _____ regj. Datë _____
FUNKSIONET E BORDIT TË ADMINISTRIMIT - Garanton qëndrueshmërinë financiare të institucionit të arsimit të lartë dhe përmbushjen e misionit të tij. - Me propozim të Senatit Akademik, miraton planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tij. - Me propozim të Senatit Akademik, miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre. - Me propozim të Senatit Akademik, miraton numrin e personelit në të gjitha nivelet. - Vlerëson paraprakisht mbylljen dhe riorganizimin e institucionit të arsimit të lartë, si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë me një institucion tjetër të arsimit të lartë. - Miraton paraprakisht hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive përbërëse të institucionit të arsimit të lartë. - Jep mendim për projekt rregulloren e institucionit dhe miraton rregulloren financiare të tij. - Përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit. - Është përgjegjës për caktimin e kriterëve e të procedurave për punësimin e administratorëve dhe personelit administrativ, mbështetur në aktet institucionit të lartë. - Emëron dhe shkarkon administratorin e institucionit. - Miraton paraprakisht statutin e institucionit të arsimit të lartë përpara se t'i përcillet Senatit Akademik. - Miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit, të hartuar nga Rektorati.	
KRITERET PËR TË KANDIDUAR PËR ANËTAR TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT - Të jenë ekspertë të njohur nga fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike e juridike. - Të jetë person me profil publik dhe arritje të shquara brenda apo jashtë vendit, në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike. - Të ketë integritet etik dhe profesional. - Të mos jetë i angazhuar në funksione drejtuese partiake. - Të mos jetë i dënuar penalisht, me vendim gjyqësor të formës së prerë (është i vlefshëm edhe vetëdeklarimi deri në marrjen e dokumentit) - Të mos ketë konflikt interesin në përmbushje të kërkesave dhe dispozitave ligjore për parandalimin e konfliktit të interesave.	
DOKUMENTACIONI SHOQËRUES - Fotokopje e dokumentit të identifikimit - Fotokopje e titullit akademik (nëse ka) - Dokumentacion shtesë që kandidati e vlerëson të rëndësishëm në mbështetje të kandidimit të tij	
TË DHËNA TË KANDIDATIT (Plotëso me germa të mëdha, vendos shenjën X ne kuti)	
Emri	Data e kërkesës
Atësia	Nr. i ID
Mbiemri	Gjinia
Datëlindja	M ☐ F ☐
Pozicioni aktual (para kandidimit)	
Unë aplikanti paraqes KËRKESË për regjistrim si kandidat për anëtar të Bordit të Administrimit, pasi jam njohur dhe në përputhje me VKM nr. 782, datë 26.12.2018, shkresën së MASR me Nr. 322, Prot., datë 14.01.2019, si dhe VSA nr. 06 më datë 23. 01. 2019 për “Shpalljen e zgjedhjeve të reja, për l vend nga radhët e përfaqësuesve të MASR, si ekspertë të njohur në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike, për anëtar të bordit të administrimit, i cili do të përzgjidhet nga studentët e Universitetit të Arteve”, për zgjedhjet që do të mbahen në datën 20 Shkurt 2019. Gjithashtu deklaroj se të dhënat e paraqitura nga ana ime në këtë kërkesë si dhe dokumentacioni shoqërues janë të sakta dhe të vërteta. Jam në dijeni se deklaratimet e rreme nga ana ime në këtë kërkesë si dhe paraqitja e dokumenteve të falsifikuara, përveç përgjegjësisë penale, sjell automatikisht heqjen e të drejtës për kandidim.	
KANDIDATI _____ Emri dhe mbiemri	NËNSHKRIMI



NJOFTIM

Nr. 265, datë 6.2.2019

**PËR APLIKIMIN E KANDIDATËVE PËR
ANËTAR TË BORDIT TË
ADMINISTRIMIT NË
UNIVERSITETIT TË SPORTEVE
TË TIRANËS**

TIRANË

Në zbatim të urdhrit të MASR-it, nr. 41, dt. 24.1.2019, *“Për njoftimin e fillimit të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, mënyrën e vlerësimit të kandidatëve dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit”*, në shkresën e Rektoratit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, nr. 128 prot., dt. 16.1.2019, “Mbi zbatimin e VKM-së nr. 782, datë 26.12.2018, *“Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në IPAL”*, në njoftimin e KIZ-it, nr. 1, dt. 31.1.2019, “Kandidatët për anëtar të Bordit të Administrimit”, nga **ora 9:00** deri në **orën 15:00**, në zyrën e protokollit të Universitetit të Sporteve të Tiranës hapen regjistrimet për të gjithë të interesuarit që do të aplikojnë në pozicionin e anëtarit të Bordit të Administrimit të UST-së. Afati i dorëzimit të dosjeve është **deri në pesë ditë pas shpalljes** në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, Buletin e Njoftimeve Zyrtare të Qendrës së Botimeve Zyrtare dhe në Buletin e Agjencisë së Prokurimit Publik.

Kandidati aplikues duhet të plotësojë kërkesat si më poshtë:

a) Kërkesat e përgjithshme:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos ketë marrë masë disiplinore të largimit nga detyra në institucionet ku ka qenë i punësuar më parë;
- Të mos jetë i dënuar penalisht, me vendim gjyqësor të formës së prerë.

b) Kërkesat e veçanta që duhet të plotësojë kandidati

- Të jetë person me profil publik dhe arritje të shquara brenda apo jashtë vendit në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike.

- Të ketë të paktën 10 vjet përvojë pune në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike e juridike. Përparësi do të kenë kandidatët me përvojë praktike në sistemin e arsimit të lartë.

- Të ketë integritet etik dhe profesional.

- Të mos jetë i angazhuar në funksione drejtuese partiake.

- Të jetë i padënuar ose ndaj tij të mos jenë dhënë masa sigurie apo dënim me vendim jopërfundimtar për kryerjen e krimeve, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar.

- Të mos ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

- Të njohë të paktën një gjuhë të huaj.

- Të mos ketë konflikt interesi në përmbushje të kërkesave dhe dispozitave ligjore.

Lista e dokumentacionit, vendi dhe afati i dorëzimit që kandidati duhet të paraqesë:

- Kërkesë për aplikim ku të jetë specifikuar IAL-i ku kandidon.

- Jetëshkrim të plotësuar në gjuhën shqipe (CV - Curriculum Vitae).

- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën “Bachelor”). Për diplomat dhe certifikatat e lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar jashtë Republikës së Shqipërisë, të përcillet Vërtetimi i Njohjes dhe i Njehsimit të Diplomës /Certifikatës të lëshuara nga strukturat përgjegjëse përkatëse.

- Fotokopje të librezës së punës.

- Fotokopje të letërnjoftimit (ID).

- Vërtetim të gjendjes gjyqësore.

- Vërtetim të lëshuar nga gjykata.

- Vetëdeklarim mbi mosangazhimin në funksione drejtuese partiake, sipas formatit të shtojcës nr. 1/1.



- Vetëdeklarim mbi konfliktin e interesit, sipas formatit të shtojcës nr. 1/2.

- Vetëdeklarim për verifikimin e vërtetësisë së dokumenteve të paraqitura nga kandidati, sipas shtojcës nr. 1/3.

- Dëshmi të mbrojtjes së gjuhës së huaj.

- Vetëdeklarim se nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

Paraqitja e dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhet në një nga këto mënyra:

1. Me postë zyrtare në adresë të Universitetit të Sporteve të Tiranës.

2. Dorëzim dorazi në ambientet e Zyrës së Protokollit në Universitetin e Sporteve të Tiranës.

SHTOJCA NR. 1/1

Vetëdeklarim mbi mosangazhimin në funksione drejtuese partiake

Deklaruesi:

Unë, _____ i nënshkruari _____, që po paraqes aplikimin tim për anëtar Bordi Administrimi në institucionet publike të arsimit të lartë, deklaroj se _____ i angazhuar në funksione drejtuese partiake.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklaramit.

Datë _____

Nënshkrimi _____

SHTOJCA NR. 1/2

Vetëdeklarim mbi konfliktin e interesit

Deklaruesi:

Unë, _____ i nënshkruari _____, që po paraqes aplikimin tim për anëtar Bordi Administrimi në institucionet publike të arsimit të lartë, deklaroj se _____ në kushtet e konfliktit të interesit që parashikon ligji nr. 9367, dt. 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, dhe legjislacioni në fuqi, për të ushtruar këtë detyrë.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklaramit.

Datë _____

Nënshkrimi _____

SHTOJCA NR. 1/3

Vetëdeklarim për verifikimin e vërtetësisë së dokumenteve të paraqitura nga kandidati

Unë, _____ i nënshkruari _____, kandidat në procesin e konkurrimit për anëtar bordi në institucionet publike të arsimit të lartë, autorizoj Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të verifikojë në çdo kohë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga ana ime.

Datë _____

Nënshkrimi _____

KËRKESË

Nr. 622/1, datë 6.2.2019

**PËR SHPREHJE INTERESI
PËR SHËRBIM KONSULENCE
“Ekspert Prokurimi”**

**Konsulent Individual Lokal - Ref. no.
SAMP/CS/IC/02-2019**

Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale - (SAMP)

Hua No.: 8841- AL

Nr. i identifikimit të Projektit: P162079

Republika e Shqipërisë ka marrë një financim shtesë nga Banka Botërore nëpërmjet kostos së Projektit të Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP), dhe ka planifikuar të përdorë një pjesë të saj për shërbim konsulence. Shërbimi i konsulencës (“Shërbim”) së kërkuar është **“Ekspert Prokurimi”**.

Termat e detajuara të Referencës (TOR) për këtë shërbim gjenden në faqen e internetit si vijon: <http://www.shendetesia.gov.al/kerkesa-per-shprehje-interesi/>

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet Ekspertit të Menaxhimit të Projektit SAMP fton të gjithë konsulentët legjitimë (“Konsulentë”) të shfaqin interesimin e tyre në ofrimin e shërbimeve të kërkuara. Konsulentët e interesuar duhet të ofrojnë informacion, ku të demonstrojnë se ato kanë kualifikimet e kërkuara dhe eksperiencat e ngjashme për të kryer shërbimin e kërkuar.



Kriteret e shortlistimit janë:

1. Kualifikimet e përgjithshme	30 pikë
2. Eksperienca të ngjashme	40 pikë
3. Aftësia për të kryer shërbimin	30 pikë
Totali	100 pikë

Konsulentët e interesuar duhet të marrin në konsideratë politikën dhe klauzolat e Bankës Botërore në lidhje me konfliktin e interesit, e përcaktuar kjo në seksionin III, paragrafët 3.14, 3.16 dhe 3.17 të "Rregullave të Prokurimit të Bankës Botërore për Huamarrësit e FPI-së", të datës korrik 2016 ("Rregullat e Prokurimit").

Metoda e përzgjedhjes që do të aplikohet është përzgjedhje sipas konsulencës individuale (IC), në përputhje me procedurën e përcaktuar në Rregullat e Prokurimit.

Konsulenti do të kontraktohet me kohë të plotë pune për periudhën që fillon nga shkurti 2019 dhe vazhdon deri më 30 qershor 2021.

Për më shumë informacion mund të kontaktoni në adresën e mëposhtme gjatë orarit zyrtar 08:00-16:30 nga e hëna deri të enjten dhe 08:00-14:00 të premten.

Shprehjet e interesit duhet të dorëzohen me shkrim në adresën e mëposhtme (dorazi ose me *e-mail*) deri në **21 shkurt 2019**.

Ekipi i Menaxhimit të Projektit (PMT)

Projekti i Modernizimit të Asistencës

Sociale (SAMP)

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes

Sociale – Kati I

“Rruga e Kavajës”, nr. 53, AL - 1001, Tiranë, ALBANIA

Në vëmendje të: Znj. Suzana Papadhopulli

e-mail: samp.papadhopulli@gmail.com

NJOFTIM

Nr. 1154, datë 11.2.2019

**PËR SHPALLJEN E POZICIONIT
KËSHILLTAR LIGJOR NË
INSTITUCIONIN E KOMISIONIT TË
PAVARUR TË KUALIFIKIMIT**

Në zbatim të nenit 22, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shpall fillimin e procedurave për personat e interesuar që kërkojnë të aplikojnë për pozicionin e Këshilltarit Ligjor në Komisionin e

Pavarur të Kualifikimit, kategoria e pagës: 80% e G3.

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

a) Të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë “master i shkencave” në Shqipëri ose studimet universitare për drejtësi jashtë vendit dhe ka marrë diplomë të njësuar sipas legjislacionit në fuqi për njësimin e diplomave.

b) Të zotërojë shumë mirë gjuhën angleze.

c) Të ketë shtatë vjet përvojë pune në sistemin e drejtësisë ose në administratën publike.

Kushte të përgjithshme:

- Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret për t’u pajisur me certifikatë sigurie sipas vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 188, datë 4.3.2015.

- Ndaj tij të mos jetë nisur procedim penal, të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose kundërvajtjeje penale.

- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore me largim nga detyra ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit.

- Kandidatët duhet të kenë aftësi për t’u përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

Kandidati i interesuar duhet të dorëzojë dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim, shprehje interesi.

2. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare.

3. Kopje të dokumenteve (diplomë, letërnjoftim, librezë pune (origjinale ose të noterizuar).

4. Dëshmi penaliteti.

5. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt.

6. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Aplikimet duhet të dorëzohen brenda 15 ditëve pas publikimit të njoftimit pranë institucionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në adresën: “Rruga e Kavajës”, Ish-Lidhja e Shkrimtarëve, Tiranë, zyra e protokollit, nga e hëna-premte ora 8:30-17:00, ose nëpërmjet postës elektronike në adresën: info@kpk.al i cili konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit.

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2019